**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria –Vlada-Government*

---

# PROJEKTLIGJI PËR INSPEKTORATIN E ARSIMIT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS[1]

# DRAFT LAW ON THE EDUCATION INSPECTORATE IN THE REPUBLIC OF KOSOVA[2]

# NACRT ZAKONA O INSPEKTORATU ZA OBRAZOVANJE U REPUBLICI KOSOVO[3]

---

[1] Projektligji për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës, është miratuar në mbledhjen e 233-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me Vendimin Nr. 09/233, të datës 27.11.2024;
[2] Draft Law on the Education Inspectorate in the Republic of Kosova, has been approved in the 233th Meeting of the Government of the Republic of Kosovo, through Decision No. 09/233, dated 27.11.2024;
[3] Nacrt Zakona o Inspektoratu za Obrazovanje u Republici Kosovo, je usvojen na 233 sednici Vlade, Odlukom Br. 09//233, održanoj 27.11.2024

| | | |
|---|---|---|
| **Kuvendi i Republikës së Kosovës;**<br><br>**Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,**<br><br>**Miraton:**<br><br>**LIGJ PËR INSPEKTORATIN E ARSIMIT NË REPUBLIKËN E KOSOVËS**<br><br>**Neni 1**<br>**Qëllimi**<br><br>Ky ligj përcakton statusin, kompetencat, përgjegjësitë dhe organizimin e Inspektoratit të Arsimit në Republikën e Kosovës.<br><br>**Neni 2**<br>**Fushëveprimi**<br><br>Ky ligj trajton mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të aplikueshëm në të gjitha institucionet publike dhe private që ofrojnë shërbime edukative, arsimore dhe aftësuese. | **Assembly of the Republic of Kosova;**<br><br>**Pursuant to Article 65 (1) of the Constitution of the Republic of Kosova,**<br><br>**Approves:**<br><br>**LAW ON THE EDUCATION INSPECTORATE IN THE REPUBLIC OF KOSOVA**<br><br>**Article 1**<br>**The purpose**<br><br>This law defines status, competencies, responsibilities and organization of the Education Inspectorate in the Republic of Kosova.<br><br>**Article 2**<br>**Scope**<br><br>This law deals with the supervision of the implementation of applicable legislation at all public and private institutions, that provide upbringing, educational and training services. | **Skupština Republike Kosova;**<br><br>**Na osnovu člana 65 (1) Ustava Republike Kosovo,**<br><br>**Usvaja:**<br><br>**ZAKON O INSPEKTORATU ZA OBRAZOVANJE U REPUBLICI KOSOVO**<br><br>**Član 1**<br>**Cilj**<br><br>Ovaj zakon definiše status, ovlašćenja, odgovornosti i organizaciju Inspektorata za obrazovanje u Republici Kosovo.<br><br>**Član 2**<br>**Oblast delovanja**<br><br>Ovaj zakon se bavi nadzorom sprovođenja važećeg zakonodavstva u svim javnim i privatnim institucijama koje pružaju edukativno, obrazovne i osposobljavajuće usluge. |

| Neni 3<br>**Përkufizimet** | Article 3<br>**Definitions** | Član 3<br>**Definicije.** |
|---|---|---|
| 1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë kuptimin si vijon: | 1. Terms used in this Law have the following meaning: | 1. Izrazi upotrebljeni u ovom zakonu imaju sledeći značaj: |
| 1.1. Inspektim administrativ – veprim i kryerjes së një inspektimi lidhur me funksionimin administrativ dhe ligjor të institucioneve arsimore siç përcaktohet në këtë ligj; | 1.1. Administrative inspection – action of carrying out an inspection related to the administrative and legal functioning of educational institutions as defined in this law; | 1.1. Administrativna inspekcija - radnja vršenja inspekcijskog nadzora u vezi administrativnog i pravnog funkcionisanja obrazovnih institucija kao što je utvrđeno ovim zakonom; |
| 1.2. Kritere të pranimit – kritere zyrtare për pranimin e nxënësve dhe të studentëve në institucionet arsimore të të gjitha niveleve; | 1.2. Admission criteria – official criteria for the admission of pupils and students at all levels in the educational institutions; | 1.2. Kriterijumi za prijem – zvanični kriterijumi za prijem učenika i studenata u obrazovnim institucijama svih nivoa; |
| 1.3. Drejtor – udhëheqësi i një institucioni arsimor; | 1.3. Principal - head of the educational institution; | 1.3. Direktor – rukovodilac obrazovne institucije; |
| 1.4. Inspektim arsimor – secila formë e kontrollit e kryer nga inspektorët arsimorë; | 1.4. Educational inspection – any form of control carried out by educational inspectors; | 1.4. Inspekcija u obrazovanje – svaki vid kontrole koju sprovode inspektori obrazovanja; |
| 1.5. Inspektorati i Arsimit – njësi ekzekutive e Ministrisë. Nëse një ligj që ka hyrë në fuqi para këtij Ligji, e definon me një emër tjetër strukturën përgjegjëse për inspektimin arsimor të Ministrisë, atëherë ai ligj do të supozohet që i referohet Inspektoratit të | 1.5. Education inspectorate - executive unit of the ministry. If a law that entered into force before this Law defines the structure responsible for the educational inspection of the Ministry with a different name, then that law shall be deemed to refer to the Inspectorate of | 1.5. Inspektorat za obrazovanje – izvršna jedinica Ministarstva. Ako je jedan zakon koji je stupio na snagu pre ovog Zakona, definiše drugim nazivom odgovornu strukturu za inspekciju u obrazovanje Ministarstva, onda će se smatrati da se taj zakon odnosi na |

| | | |
|---|---|---|
| Arsimit siç është përcaktuar në këtë pikë; | Education as defined in this clause; | Inspektorat za obrazovanje kako što je definisano u ovoj tučci; |
| 1.6. DKA – Drejtoria Komunale e Arsimit. | 1.6. MED– Municipality Education Directorate. | 1.6. ODO– Opštinski direktorijat za obrazovanje. |
| 1.7. Institucioni arsimor – përfshin çdo institucion edukativ, arsimor dhe aftësues, i cili ofron shërbime arsimore në nivelet SNKA 0-6; | 1.7. Educational institution – includes any upbringing, educational and training institution, which provides educational services at ISCED levels 0-6; | 1.7. Obrazovna institucija – obuhvata svaku edukativno, obrazovnu i osposbljavajuću instituciju, koja pruža obrazovne usluge na nivou SNKA 0-6; |
| 1.8. Vlerësim i jashtëm i nxënësve – provime shtetërore të cilat janë përgatitur, administruar dhe vlerësuar në pajtim me standardet e përcaktuara nga organi i autorizuar përtej nivelit të shkollës; | 1.8. External assessment of students - state exams that are prepared, administered and evaluated in accordance with the standards set by the authorized body beyond the school level; | 1.8. Eksterno vrednovanje učenika - državni ispiti koji se pripremaju, administriraju i vrednuju u skladu sa standardima koje utvrđuje nadležni organ van nivoa škole; |
| 1.9. Vlerësim i jashtëm i shkollës – kontrolli i planifikuar, sistematik i standardeve në fushat e cilësisë të përcaktuara nga Ministria përgjegjëse, i cili kryhet në intervale të rregullta nga inspektorët e arsimit në bazë të kritereve dhe treguesve të përcaktuara me Kornizën për sigurimin e cilësisë; | 1.9. External evaluation of the school – planned, systematic control of standards in the quality areas defined by the ministry in charge, which is carried out at regular intervals by education inspectors based on the criteria and indicators defined by the Quality Assurance Framework; | 1.9. Eksterno vrednovanje škole – planska, sistematska kontrola standarda u oblastima kvaliteta definisanim od strane relevantnog ministarstva, koja se obavlja u redovnim intervalima od strane inspektora za obrazovanje na osnovu kriterijuma i indikatora definisanih Okvirom za obezbeđivanje kvaliteta; |
| 1.10. Ekspert i jashtëm – ekspert profesional/pedagogjik në një apo më shumë fusha kurrikulare, i cili i këshillon inspektorët në inspektim | 1.10. External Expert – professional/pedagogical associate in one or more curricular areas, who advises inspectors in the pedagogical | 1.10. Eksterni stručnjak – stručni/pedagoški stručnjak za jednu ili više nastavnih oblasti, koji savetuje inspektore u pedagoškoj inspekciji i koji |

| | | |
|---|---|---|
| pedagogjik dhe i cili nuk duhet të jetë i punësuar në shkollën që inspektohet; | inspection and who must not be an employee of the school being inspected; | ne sme biti zaposleni u školi u kojoj se vrši inspekcijski nazor; |
| 1.11. Kryeinspektori/ja – nëpunës civil i rangut më të lartë që e udhëheq si shef individual, Inspektoratin e Arsimit; | 1.11. The Chief Inspector – the highest-ranking civil servant, who leads the Education Inspectorate as an individual chief; | 1.11. Glavni inspektor/ka – civilni službenik najvišeg ranga, koji vodi kao individualni šef, Inspektorata za obrazovanje; |
| 1.12. Udhëheqës i Sektorit të Inspektoratit të Arsimit – inspektor i arsimit i cili udhëheq sektorin përkatës; | 1.12. Head of the Education Inspectorate Sector – education inspector who leads the relevant sector. | 1.12. Rukovodilac sektora Inspektorata za obrazovanje – inspektor u obrazovanje koji vodi odgovarajući sektor. |
| 1.13. Zyrtar në Inspektoratin e Arsimit – shërbyesi civil në inspektoratin e arsimit; | 1.13. Officer in the Education Inspectorate – civil servant in the Education Inspectorate; | 1.13. Službenik u Inspektorat za obrazovanje – civilni službenik u Inspektorat za obrazovanje; |
| 1.14. Këshilli drejtues– organ përgjegjës për qeverisjen e një institucioni arsimor me funksionet e përcaktuara me legjislacionin në fuqi; | 1.14. Steering council - responsible body for the governance of an educational institution with functions defined by the legislation in force; | 1.14. Upravni savet – organ odgovoran za upravljanje obrazovnom institucijom sa određenim funkcijama utvrđenim zakonom; |
| 1.15. Ekipi inspektues – ekipi i inspektorëve dhe ekspertëve të tjerë të jashtëm që kryen inspektime në institucione arsimore; | 1.15. Inspecting team - the team of inspectors and other external experts who conduct inspections in educational institutions; | 1.15. Inspekcijska ekipa – ekipa inspektora i drugih eksternih stručnjaka koji vrše inspekcijski nadzor u obrazovnim institucijama; |
| 1.16. Inspektor i arsimit – zyrtar publik, nëpunës civil i ministrisë përgjegjëse të fushës së arsimit i cili ka kompetencë për inspektim, mbikëqyrje dhe monitorim të cilësisë së arsimit në të gjitha nivelet dhe në gjuhët që | 1.16. Education inspector - the public official, civil servant of the Ministry who has competence for inspection, supervision and monitoring of the education quality at all levels and in the languages where education takes place | 1.16. Inspektor obrazovanja - javni službenik, službeno lice ministarstva, odgovorno za oblast obrazovanja koje ima nadležnosti da obavlja inspekciju, nadzor i monitoring kvaliteta obrazovanja na svim nivoima i na |

| | | |
|---|---|---|
| zhvillohet arsimi në Kosovë; | in Kosova; | jezicima na kojima se odvija nastava na Kosovu; |
| 1.17. Vlerësim i brendshëm – kontrolli i planifikuar, sistematik i standardeve në fushat e cilësisë të përcaktuara nga Ministria, i cili kryhet nga shkolla në intervale të rregullta, duke u bazuar në kritere dhe tregues siç përshkruhet në Kornizën e sigurimit të cilësisë; | 1.17. Internal evaluation - planned, systematic control of standards in the quality areas defined by the ministry, which is carried out by the school at regular intervals, based on criteria and indicators as described in the Quality Assurance Framework; | 1.17. Interno vrednovanje – planska, sistematska kontrola standarda u oblastima kvaliteta definisanim od strane Ministarstva, koje se obavlja od strane škole u redovnim intervalima, na osnovu kriterijuma i indikatora kao što je definisano u ovom Okviru za obezbeđivanje kvaliteta; |
| 1.18. SNKA – Standardi Ndërkombëtar i Klasifikimit të Arsimit, i miratuar nga UNESCO në Konferencën e përgjithshme, në sesionin e saj të 29-të, në nëntor të vitit 1997, me ndryshimet e mëvonshme; | 1.18. ISCED – International Standard of Education Classification, approved by UNESCO at the General Conference, in its 29th session, in November 1997, with subsequent amendments; | 1.18. MSKO - Međunarodni standardi klasifikacije obrazovanja, odobren od strane UNESCO na Generalnoj konferenciji, na njenom 29-tom zasedanju u novembru 1997, i sa kasnijim izmenama; |
| 1.19. Materiale mësimore dhe mjete të konkretizimit – tekstet shkollore, softueri kompjuterik, e tjera, që përdoren në klasë; | 1.19. Teaching materials and concretization means - textbooks, computer software, others, used in the classroom; | 1.19. Nastavni materijali i sredstva konkretizacije – školski udžbenici, računarski softveri, i drugo, koje se koriste u učionici; |
| 1.20. Licencimi – procesi i lëshimit të lejeve për ushtrimin e punës së mësimdhënësit dhe detyrave të tjera në shkollë; | 1.20. Licensing - the process of issuing permits for exercising the work of a teacher and other duties in the school; | 1.20. Licenciranje – proces izdavanja dozvole za obavljanje posao nastavnik i drugih poslova u školi; |
| 1.21. Vlerësimi – i referohet proceseve që përdoren për të grumbulluar, analizuar dhe vlerësuar dëshmitë e arritjeve individuale në mësimdhënie, | 1.21. Evaluation - refers to the processes used to collect, analyze and evaluate evidence of individual achievement in teaching, professional practice of the | 1.21. Ocenjivanje – odnosi se na procese koji se koriste za prikupljanje, analizu i ocenjivanje dokaza o individualnim dostignućima u nastavi, |

| | | |
|---|---|---|
| praktikë profesionale të udhëheqjes së institucionit arsimor dhe arritjes së pritshmërive nga institucioni arsimor; | leadership of the educational institution and the expectation achievement of the educational institution. | stručnoj praksi rukovođenje obrazovne institucije kao i ostvarenju očekivanja od strane obrazovne institucije; |
| 1.22. Performanca – tërësia e punës dhe rezultateve të punës së mësimdhënësve, drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve dhe institucioneve arsimore, në kuadër të kompetencave për mësimdhënës, standardeve të praktikës profesionale për drejtorë të shkollave dhe kritereve të cilësisë së shkollës; | 1.22. Performance – The totality of work and work outcomes of teachers, principals, vice principals and educational institutions, within the competences for teachers, professional practice standards for school principals and school quality criteria; | 1.22. Performansa – celina rada i rezultati rada nastavnika, direktora i zamenika direktora i obrazovne institucije, u okviru nadležnosti za nastavnike, standardi stručne prakse za direktore škola i kriterijume kvaliteta škole. |
| 1.23. Ministria – Ministria përgjegjëse për arsimin, shkencën, teknologjinë dhe inovacionin si autoritet qeveritar kompetent, përgjegjësitë e të cilës përfshijnë arsimin, shkencën, teknologjinë dhe inovacionin; | 1.23. Ministry - the Ministry responsible for Education, Science, Technology and Innovation as a competent government authority whose responsibilities include education, science, technology and innovation; | 1.23. Ministarstvo – Ministarstvo nadležno za obrazovanje, nauku, tehnologiju i inovacije kao nadležni vladin organ u čije su nadležnosti obrazovanje, nauka, tehnologija i inovacije; |
| 1.24. Inspektim pedagogjik – veprim i kryerjes së një inspektimi lidhur me cilësinë pedagogjike në institucionet e arsimit parauniversitar siç përcaktohet në këtë Ligj; | 1.24. Pedagogical inspection – action of conducting an inspection related to the pedagogical quality in pre-university education institutions as defined in this Law; | 1.24. Pedagoška inspekcija - radnja vršenja inspekcijskog nadzora u pegaškom svojstvu u institucijama preduniverzitetskog obrazovanja kao što je utvrđeno ovim zakonom; |
| 1.25. Staf profesional i institucionit arsimor – pedagogët, psikologët, punëtorët social dhe bashkëpunëtorët profesional; | 1.25. Professional staff of the educational institution - pedagogues, psychologists, social workers and professional associates; | 1.25. Stručno osoblje obrazovne institucije – pedagozi, psiholozi, socijalni radnici i stručni saradnici; |

| | | |
|---|---|---|
| 1.26. Fushat e cilësisë së institucionit arsimor - segmentet kryesore të veprimtarisë së institucionit/shkollës që shërbejnë si pika referuese për vlerësimin e performancës së institucioneve arsimore në Kosovë, duke siguruar koherencë në mes të procesit të vetëvlerësimit dhe të vlerësimit të jashtëm të shkollës;<br><br>1.27. Korniza për sigurimin e cilësisë – politikë arsimore që përcakton kriteret e cilësisë së performancës së institucionit arsimor, procedurat e zbatimit, nivelet dhe shkallët e cilësisë.<br><br>1.28. Tregues i cilësisë – tregon nëse është përmbushur një aspekt i caktuar i performancës;<br><br>1.29. Riinspektim (ose inspektimi pasues) – inspektimi i një institucioni arsimor pas një inspektimi të përgjithshëm ose tematik për të kontrolluar nëse janë zbatuar masat dhe nëse i kanë sjellë rezultatet e dëshiruara;<br><br>1.30. Standarde – tregues të matshëm të suksesit, të përkufizuara në formë të kritereve cilësore apo sasiore, të cilat pritet të arrihen nga kandidatët në | 1.26. Quality areas of the educational institution - Main segments of the institution/school activity that serve as reference points for performance evaluation of educational institutions in Kosova, ensuring coherence between the self-assessment process and the external evaluation of the school;<br><br>1.27. Quality assurance framework – educational policy that defines the quality criteria of the educational institution performance, implementation procedures, levels and degrees of quality.<br>1.28. Quality indicator – shows whether a certain aspect of performance has been met;<br><br>1.29. Re-inspection (or follow-up inspection) – inspection of an educational institution after a general or thematic inspection to check whether the measures have been implemented and whether they brought the desired results;<br>1.30. Standards - measurable indicators of success, defined in the form of quality or quantity criteria, which are expected to be achieved by candidates | 1.26. Oblasti kvaliteta obrazovne institucije - Glavni segmenti aktivnosti institucije/škole koji služe kao referentne tačke za ocenjivanje performanse obrazovnih institucija na Kosovu, obezbeđujući koherentnost između procesa samoevaluacije i eksterne evaluacije škole;<br><br>1.27. Okvir za osiguranje kvaliteta – obrazovna politika koja definiše kriterijume kvaliteta performanse obrazovne institucije, procedure implementacije, nivoe i stepene kvaliteta.<br>1.28. Indikator kvaliteta – pokazuje da li je ispunjen određeni aspekt performanse;<br><br>1.29. Ponovljena inspekcija (ili naknadna inspekcija) – inspekcija obrazovne institucije nakon opšteg ili tematskog pregleda radi provere da li su mere sprovedene i da li su dale željene rezultate;<br><br>1.30. Standardi – merljivi pokazatelji uspeha, definisani u vidu kvalitativnih ili kvantitativnih kriterijuma, koje se očekuje da ostvare kandidati da bi stekli |

| | | |
|---|---|---|
| mënyrë që ata t'i fitojnë kualifikimet; | in order for them to obtain qualifications; | kvalifikacije; |
| 1.31. Koordinator i cilësisë – person mbështetës për sigurim të cilësisë; | 1.31. Quality Coordinator - support person for quality assurance; | 1.31. Koordinator kvaliteta – osoba za podršku za obezbeđivanje kvaliteta; |
| 1.32. Paneli i ankesave – Komision i Inspektoratit të Arsimit, i cili merret me shqyrtimin e ankesave në shkallë të dytë; | 1.32. Complaints panel – Commission of the Education Inspectorate, which deals with the review of complaints in the second degree; | 1.32. Žalbeno veće – Komisija Inspektorata za obrazovanje, koja se bavi razmatranjem žalbi na drugostepenom nivou; |
| 1.33. Inspektimet tematike – kategori e inspektimeve të cilat kanë për qëllim të identifikojnë praktika të mira apo të gabuara, të përcaktojnë nevojat që ekzistojnë në fusha të caktuara të arsimit dhe të studiojnë efektin e reformave të politikave publike dhe legjislacionit nga prizmi i një teme/problemi të caktuar; | 1.33. Thematic inspections – category of inspections which aim to identify good or bad practices, determine the needs that exist in certain fields of education, and study the effect of public policy reforms and legislation from the perspective of a particular topic/problem; | 1.33. Tematske inspekcije – kategorija inspekcija koje imaju za cilj identifikovanje dobre ili pogrešne prakse, da utvrde potreba koje postoje u određenim oblastima obrazovanja, i proučavaju efekata reformi javnih politika i zakonodavstva iz perspektive određene teme/problema; |
| 1.34. Qasja e bazuar në rrezik - procesi i punës që zhvillohet dhe zbatohet nga organet inspektuese dhe që ka për qëllim analizimin, planifikimin dhe realizimin e inspektimeve, duke u fokusuar në ato subjekte të dhënies së shërbimeve arsimore të cilat paraqesin rrezikun më të madh dhe më të drejtpërdrejtë për interesin publik, duke përfshirë cilësinë, ligjshmërinë, sigurinë publike apo mjedisin mësimnxënës; | 1.34. Risk-based approach - the work process that is developed and implemented by the inspection bodies and that aims to analyze, plan and conduct inspections, focusing on those subjects of the educational service provision which pose the greatest and most direct risk to the public interest, including quality, legality, public safety or the learning environment; | 1.34. Pristup zasnovan na riziku – proces rada koji razvijaju i sprovode inspekcijski organi i koji ima za cilj analizu, planiranje i sprovođenje inspekcijskog nadzora, fokusirajući se na one subjekte pružanja obrazovnih usluga koji predstavljaju najveći rizik i najdirektnije u javni interes, uključujući kvalitet, zakonitost, javnu bezbednost ili okruženje za učenje; |

| | | |
|---|---|---|
| 1.35. Metodologjia e vlerësimit të rrezikut - metodologjia për vlerësimin e rrezikut, e cila hartohet dhe miratohet nga organi përgjegjës i parashikuar në ligjin e përgjithshëm të inspektimeve të Republikës së Kosovës, e cila shërben si bazë për hartimin e planeve të inspektimit nga Inspektorati i Arsimit. | 1.35. Risk assessment methodology - the risk assessment methodology, which is compiled and approved by the responsible body provided for in the law on general inspection of the Republic of Kosova, and which serves as a basis for compiling inspection plans by the Inspectorate of Education. | 1.35. Metodologija procene rizika - metodologija procene rizika, koja se sastavlja i odobrava od strane nadležnih organa predviđena opštim zakonom o inspekciji Republike Kosovo, koja služi kao osnova za izradu planova inspekcije od strane Inspektorata za obrazovanje. |
| 2. Të gjitha shprehjet e sqaruara në ligjin e përgjithshëm për inspektimet në Republikën e Kosovës, zbatohen mutatis mutandi edhe në kuptim të këtij Ligji. | 2. All expressions clarified in the law on general inspections of the Republic of Kosova apply mutatis mutandis also in terms of this Law. | 2. Svi pojašnjeni izrazi u opštem zakonu o inspekcijama u Republici , Kosovo primenjuju mutatis mutandi i u smislu ovog Zakona. |
| **Neni 4**<br>**Parimet** | **Article 4**<br>**Principles** | **Član 4**<br>**Principi** |
| 1. Parimet themelore të Inspektoratit të Arsimit, përveç të atyre që janë të parashikuara në ligjin e përgjithshëm të inspektimeve të Republikës së Kosovës, janë: | 1. The basic principles of the Education Inspectorate, in addition to those provided for in the Law on General Inspection of the Republic of Kosova, are: | 1. Osnovni principi Inspektorata za obrazovanje, pored onih predviđanih opštim zakonom o inspekciji Republike Kosovo, su: |
| 1.1. Ndershmëria dhe integriteti; | 1.1. Honesty and integrity; | 1.1. Iskrenost i integritet; |
| 1.2. Ligjshmëria; | 1.2. Lawfulness; | 1.2. Zakonitost; |
| 1.3. Profesionalizmi; | 1.3. Professionalism; | 1.3. Profesionalizam; |
| 1.4. Objektiviteti dhe paanshmëria; | 1.4. Objectivity and impartiality; | 1.4. Objektivnost i nepristrasnost; |

| | | |
|---|---|---|
| 1.5. Llogaridhënia dhe përgjegjësia. | 1.5. Accountability and responsibility. | 1.5. Polaganje računa i odgovornost. |
| 2. Në të gjitha veprimtaritë e tij, Inspektorati i Arsimit vendos në radhë të parë interesin e nxënësve dhe të studentëve. | 2. In all its activities, the Education Inspectorate puts the interests of pupils and students first. | 2. Inspektorat za obrazovanje u svim svojim aktivnostima na prvom mestu stavlja interese učenika i studenata. |
| 3. Përfundimet e inspektorëve nxirren vetëm: | 3. The conclusions of the inspectors are drawn only: | 3. Zaključci inspektora se donose samo: |
| 3.1. Nëpërmjet vëzhgimeve të drejtpërdrejta të veprimtarisë së institucioneve dhe individëve; | 3.1. Through direct observations of the institutions and individuals activity; | 3.1. Kroz neposredna posmatranja aktivnosti institucija i pojedinaca; |
| 3.2. Mbi bazën e të dhënave të siguruara nga inspektimet; | 3.2. On the basis of data provided by inspections; | 3.2. Na osnovu podataka dobijenih od inspekcije; |
| 3.3. Pasi është grumbulluar material i duhur dhe i mjaftueshëm, që bën të mundur një vlerësim të saktë, të qartë, bindës dhe të besueshëm; | 3.3. After adequate and sufficient material has been collected, which makes possible an accurate, clear, convincing and reliable assessment; | 3.3. Nakon što je prikupljen adekvatan i dovoljan materijal koji omogućava tačnu, jasnu, ubedljivu i pouzdanu procenu; |
| 3.4. Pasi janë analizuar të dhënat me korrektësi. | 3.4. After the data has been analyzed correctly. | 3.4. Nakon što su podaci pravilno analizirani. |
| 4. Inspektori i arsimit dhe institucioni arsimor vendosin marrëdhënie korrekte të punës të bazuar në profesionalizëm dhe mirëkuptim. | 4. The education inspector and the educational institution establish a the workplace relationship based on professionalism and understanding. | 4. Inspektor za obrazovanje i obrazovna institucija uspostavljaju korektne odnose rada zasnovane na profesionalizam i razumevanju. |
| 5. Inspektori i arsimit nuk inspekton institucionin ku ka konflikt interesi sipas | 5. The education inspector does not inspect the institution where there is a | 5. Inspektor za obrazovanje ne vrši inspekciju institucije u kojoj postoji sukob |

| | | |
|---|---|---|
| legjislacionit në fuqi.<br><br>6. Inspektorati i arsimit respekton parimin e proporcionalitetit në politikën e saj të punësimit ndaj komuniteteve joshumicë.<br><br>**Neni 5**<br>**Statusi ligjor**<br><br>1. Inspektorati i Arsimit është njësi ekzekutive qendrore për vlerësimin dhe sigurimin e zbatimit të legjislacionit në fushën e arsimit në Republikën e Kosovës, në varësi të drejtpërdrejtë të ministrit/es të MASHTI.<br><br>2. Selia qendrore e Inspektoratit të Arsimit është në Prishtinë dhe ka degët lokale në Prishtinë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë, Pejë, Gjilan dhe Gjakovë.<br><br>3. Inspektorati i Arsimit ka logon e vet, vulën katrore dhe të rrumbullakët.<br><br>4. Logo dhe teksti i vulave rregullohet përmes aktit nënligjor.<br><br>**Neni 6**<br>**Funksionet e Inspektoratit të Arsimit**<br><br>1. Inspektorati i Arsimit është trupë | conflict of interest according to the legislation in force.<br>6. The Education Inspectorate respects the principle of proportionality in its employment policy towards non-majority communities.<br>**Article 5**<br>**Legal status**<br><br>1. The Education Inspectorate is the central executive unit for evaluating and ensuring the implementation of legislation in the field of education in the Republic of Kosova, directly dependent on the Minister of the Ministry.<br><br>2. The headquarter of the Education Inspectorate is in Prishtina and has local branches in Prishtina, Prizren, Ferizaj, Mitrovica, Peja, Gjilan and Gjakova.<br><br>3. Education inspectorate has its logo, square and round seal.<br><br>4. The logo and text of the seals is regulated through the sub-legal act.<br><br>**Article 6**<br>**Functions of the Education Inspectorate**<br><br>1. The Education Inspectorate is an | interesa u skladu sa važećim zakonima.<br><br>6. Inspektor za obrazovanje poštuje princip proporcionalnosti u svojoj politici zapošljavanja prema nevećinskim zajednicama.<br>**Član 5**<br>**Pravni status**<br><br>1. Inspektorat za obrazovanje je centralna izvršna jedinica za ocenjivanje i obezbeđivanje sprovođenja zakonodavstva u oblasti obrazovanja u Republici Kosovo, direktno podređen ministru/ke Ministarstva.<br><br>2. Sedište Inspektorata za obrazovanje je u Prištini i ima lokalne ogranke u Prištini, Prizrenu, Uroševcu, Mitrovici, Peći, Gnjilanu i Đakovici.<br><br>3. Inspektorat za obrazovanje ima svoj logo, četvrtasti i okrugli pečat.<br><br>4. Logo i tekst pečata uređuju se podzakonskim aktom.<br><br>**Član 6**<br>**Funkcije Inspektorata za obrazovanje**<br><br>1. Inspektorat za obrazovanje je |

| | | |
|---|---|---|
| inspektuese sipas ligjit të përgjithshëm të inspektimeve të Republikës së Kosovës dhe ushtron këto funksione:<br><br>1.1.Funksionin vlerësues - vlerëson cilësinë e shërbimit të institucioneve arsimore publike dhe private;<br><br>1.2. Funksionin kontrollues - kontrollon pajtueshmërinë e veprimtarisë së institucioneve arsimore me legjislacionin në fuqi.<br><br>1.3. Funksionin këshillues - këshillon drejtuesit dhe punonjësit e institucioneve arsimore dhe u raporton organeve politikbërëse mbi nivelet e zbatimit të këshillave të saj.<br><br>1.4. Funksionin informues/raportues - informon ministrin, DKA-të dhe institucionet arsimore për gjetjet e inspektimit si dhe i publikon ato në baza vjetore.<br><br>1.5. Funksioni mbështetës - promovon praktikat e suksesshme të institucioneve arsimore dhe zhvillimin e politikave arsimore.<br><br>2. Detyrat për kryerjen e këtyre | inspection body according to the law on general inspection of the Republic of Kosova and exercises the following functions:<br>1.1. Evaluating function - evaluates the service quality of public and private educational institutions;<br><br>1.2. Controlling function – controls the compliance of the educational institutions activity with the legal and sub-legal acts in force.<br><br>1.3. Advisory function - advises leaders and employees of educational institutions and reports to policy-making bodies on the implementation levels of its advices.<br><br>1.4. Informative/reporting function-informs the minister, MEDs and educational institutions about the inspection findings and publishes them on annual basis.<br><br>1.5. Support function - promotes successful practices of educational institutions and the development of educational policies.<br><br>2. The tasks for performing these functions | inspekcijsko telo prema opštem zakonu o inspekciji Republike Kosovo i obavlja sledeće funkcije:<br><br>1.1. Funkcija ocenjivanja – ocenjuje kvalitet usluga obrazovnih institucija javne i privatne;<br><br>1.2. Kontrolna funkcija - kontroliše usklađenost aktivnosti obrazovnih institucija sa važećim zakonodavstvom.<br><br>1.3. Savetodavna funkcija – savetuje rukovodioce i zaposlene u obrazovnim institucijama i izveštava politička tela o nivoima sprovođenja svojih saveta.<br><br>1.4. Informativna/izveštajna funkcija - obaveštava ministra, ODO i obrazovne institucije o nalazima inspekcije i objavljuje ih na godišnjem nivou.<br><br>1.5. Funkcija podrške – promoviše uspešnu praksu obrazovnih institucija i razvoj obrazovnih politika.<br><br>2. Zadaci za obavljanje ovih funkcija mogu |

| | | |
|---|---|---|
| funksioneve mund të konkretizohen më tej përmes një akti nënligjor.<br><br>**Neni 7**<br>**Organizimi i Inspektoratit të Arsimit**<br><br>1. Organizimi dhe funksionimi i brendshëm i Inspektoratit të Arsimit përcaktohet me rregulloren e organizimit të brendshëm të Ministrisë përgjegjëse për arsim dhe në respekt të detyrave dhe funksioneve të tij. Statusi i gradave të nëpunësve civil përcaktohet me akt të brendshëm të Ministrisë.<br><br>2. Struktura minimale organizative e Inspektoratit të Arsimit, është si vijon:<br><br>2.1. Zyra e Kryeinspektorit, e cila përfshin një sektor të shërbimit të menaxhimit të përgjithshëm, dhe së paku:<br><br>2.2. Një përgjegjës për inspektim administrativ;<br><br>2.3. Një përgjegjës për inspektim pedagogjik;<br><br>2.4. Degët lokale (DL) – Sektorët e | can be further specified through a sub-legal act.<br><br>**Article 7**<br>**Organization of the Education Inspectorate**<br><br>1. The internal organization and functioning of the Education Inspectorate is determined by the internal organization regulation of the Ministry responsible for education and in respect of its duties and functions. The status of the civil servants' ranks is determined by an internal act of the Ministry.<br><br>2. The minimum organizational structure of the education inspectorate is as follows:<br><br>2.1. The Chief Inspector’s Office, which includes a general management service sector, and at least:<br><br>2.2. A person in charge for the administrative inspection;<br><br>2.3. A person in charge for the pedagogical inspection.<br><br>2.4. Local branches (LB) – Sectors of | se dodatno precizirati podzakonskim aktom.<br><br>**Član 7**<br>**Organizovanje Inspektorata za obrazovanje**<br><br>1. Unutrašnja organizacija i funkcionisanje Inspektorata za obrazovanje utvrđuje se pravilnikom o unutrašnjoj organizaciji relevantnog Ministarstva za obrazovanje o poslovima u obrazovanje i u pogledu njegovih dužnosti i funkcije Status gradiranja civilnih službenika utvrđuje se internim aktom Ministarstva.<br><br>2. Minimalna organizaciona struktura Inspektorata za obrazovanje je kao u nastavku;<br>2.1. Kancelarija glavnog inspektora, koja obuhvata sektor usluga opšteg upravljanja, i najmanje:<br><br>2.2. Jednog odgovornog lice za administrativnu inspekciju;<br><br>2.3. Jednog odgovorno lice za pedagošku inspekciju.<br><br>2.4. Lokalni ogranci (LO)- Sektori |

| | | |
|---|---|---|
| Inspektoratit të Arsimit (SIA).<br><br>3. Statusi dhe themelimi i njësive të brendshme të inspektoratit përcaktohet me rregulloren e organizimit të brendshëm të Ministrisë përgjegjëse për arsim. | the Education Inspectorate (SEI).<br><br>3. The status and establishment of the internal units of the inspectorate is determined by the regulation of the internal organization of the Ministry responsible for education. | Inspektorata za obrazovanje(SIO).<br><br>3. Status i osnivanje unutrašnjih jedinica inspektorata utvrđuje se propisom o unutrašnjoj organizaciji nadležnog Ministarstva za obrazovanje. |
| **Neni 8**<br>**Detyrat dhe përgjegjësitë e kryeinspektorit** | **Article 8**<br>**Duties and responsibilities of the Chief Inspector** | **Član 8**<br>**Zadaci i odgovornosti glavnog inspektora** |
| 1. Përveç funksioneve të përcaktuara në ligjin përkatës për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore dhe agjencive ekzekutive dhe ligjin përkatës për inspektimet, kryeinspektori i Inspektoratit të Arsimit, ushtron këto funksione: | 1. In addition to the functions defined in the relevant law on the organization and functioning of the state administration and independent agencies and the relevant law on inspections, the Chief Inspector of the Education Inspectorate performs these functions: | 1. Pored funkcija definisanih odgovarajućim zakonom o uređenju i funkcionisanju državne administracije i i izvršnih agencija i odgovarajućim zakonom o inspekciji, glavni inspektor Inspektorata za obrazovanje, obavlja sledeće funkcije: |
| 1.1. Planifikon, organizon, mbikëqyrë dhe udhëheq punën e Inspektoratit të Arsimit;<br><br>1.2. Kontrollon, inspekton dhe nxjerr vendime për çështjet kontestuese në institucionet arsimore;<br><br>1.3. Inicion ose i autorizon nëpunësit tjerë për ngritjen e procedurave adekuate administrative, civile, penale, në mbrojtje të ligjshmërisë dhe rregullsisë në funksionimin e | 1.1. Plans, organizes, supervises and leads the work of the education inspectorate;<br><br>1.2. Checks, inspects and issue decision for contentious issues in educational institutions;<br><br>1.3. Initiates or authorizes other employees for establishment of adequate administrative, civil, criminal procedures, in defense of legality and regularity in the functioning of | 1.1. Planira, organizuje, nadgleda i rukovodi rad Inspektorata za obrazovanje;;<br><br>1.2. Kontroliše, vrši inspekciju i donosi rešenja o spornim pitanjima u obrazovnim institucijama;<br><br>1.3. Inicira ili ovlašćuje druge službenike, za pokretanje adekvatnih administrativnih, parničnih, krivičnih procedura, u odbrani zakonitosti i pravilnosti u funkcionisanju obrazovnih |

| | | |
|---|---|---|
| institucioneve arsimore; | educational institutions; | institucija; |
| 1.4. Nxjerr vendime dhe jep instruksione për veprimtarinë e strukturave administrative të Inspektoratit të Arsimit; | 1.4. Makes decisions and gives instructions for the activity of the administrative structures of the Education Inspectorate; | 1.4. Donosi odluke i daje instrukcije za rad administrativni struktura Inspektorata za obrazovanje; |
| 1.5. Koordinon veprimtarinë e Inspektoratit të Arsimit me organet qendrore dhe organet tjera publike në fushën e inspektimit të arsimit; | 1.5. Coordinates the Education Inspectorate activity with the central bodies and other public bodies in the field of education inspection. | 1.5. Koordinira rad Inspektorata za obrazovanje sa centralnim organima i drugim javnim organima u oblasti inspekcije u obrazovanju. |
| 1.6. Krijon dhe mban kontakte me organe homologe dhe organizata të ndryshme, për çështje që lidhen me funksionimin e Inspektoratit të Arsimit; | 1.6. Creates and maintains contacts with counterpart bodies and various organizations, for issues related to the functioning of the Education Inspectorate. | 1.6. Stvara i održava kontakte sa srodnim organima i raznim organizacijama, za pitanja u vezi sa funkcionisanjem Inspektorata za obrazovanje. |
| 1.7. Përfaqëson Inspektoratin e Arsimit në marrëdhënie me palët e treta dhe është përgjegjës për organizimin dhe koordinimin e funksionimit, si dhe për cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë së Inspektoratit të Arsimit; | 1.7. Represents the Education Inspectorate in relation to third parties and is responsible for the organization and coordination of the operation, as well as for the quality and effectiveness of the Education Inspectorate activity. | 1.7. Predstavlja Inspektorat za obrazovanje u odnosima sa trećim licima i odgovoran je za organizovanje i koordinaciju funkcionisanja, kao i za kvalitet i efektivnost delatnosti Inspektorata za obrazovanje. |
| 1.8. Planifikon bashkërisht me organet tjera të Ministrisë, inspektimet tematike; | 1.8. Plans thematic inspections, jointly with other bodies of the Ministry; | 1.8. Planira, zajedno sa drugim organima Ministarstva, tematske inspekcije; |
| 1.9. Miraton metodologjinë për vlerësim të rrezikut për fushën e inspektimeve të arsimit; | 1.9. Approves the risk assessment methodology on education inspections area. | 1.9. Odobrava metodologiju za procenu rizika u oblast inspekcije u obrazovanje. |

| | | |
|---|---|---|
| 1.10. I raporton organit qendror të inspektimeve sipas ligjit të përgjithshëm të inspektimeve të Republikës së Kosovës; | 1.10. Reports to the central inspection body according to the general inspection law of the Republic of Kosova; | 1.10. Izveštava centralni inspekcijski organ prema opštem zakonu o inspekciji u Republici Kosovo; |
| 1.11. Propozon buxhetin vjetor. | 1.11. Proposes the annual budget. | 1.11. Predlaže godišnji budžet. |
| **Neni 9**<br>**Emërimi dhe shkarkimi i kryeinspektorit** | **Article 9**<br>**Appointment and discharge of the Chief Inspector** | **Član 9**<br>**Imenovanje i razrešenje glavnog inspektora** |
| 1. Kryeinspektori emërohet nga Ministri/ja bazuar në një procedurë të hapur dhe konkurruese. | 1. The Chief Inspector is appointed by the Minister based on an open and competitive procedure. | 1. Glavnog inspektora imenuje ministar/ka po otvorenoj i konkursnoj proceduri. |
| 2. Kriteret për emërimin e Kryeinspektorit janë: | 2. The criteria for appointing the Chief Inspector are: | 2. Kriterijumi za imenovanje glavnog inspektora su: |
| 2.1. Kriteret minimale, të cilat janë kusht për të pranuar aplikacionin e kandidatit, janë: | 2.1. The minimum criteria, which are a condition for accepting the candidate's application, are: | 2.1. Minimalni kriterijumi, koji su uslov za prihvatanje aplikacije kandidata, su: |
| 2.1.1. Të kenë së paku titull master apo ekuivalent (300 ECTS); | 2.1.1. To have at least a master's degree or equivalent (300 ECTS); | 2.1.1. Da imaju najmanje zvanje master ili ekvivalento (300 ECTS); |
| 2.1.2. Të kenë të paktën pesë (5) vjet përvojë pune në fushën e administrimit publik, legjislacionit, menaxhimit ose mësimdhënies; | 2.1.2. To have at least five (5) years of work experience in the field of public administration, legislation, management or teaching; | 2.1.2. Da ima najmanje pet (5) godina radnog iskustva u oblasti javne administracije, zakonodavstva, upravljanja ili nastave; |

| | | |
|---|---|---|
| 2.1.3. Të mos ketë pasur një pozitë udhëheqëse në parti politike në tre (3) vitet e fundit; | 2.1.3. Not to have held a leadership position in a political party in the last three (3) years. | 2.1.3. Da nije bio na rukovodećoj poziciji u političkoj partiji u poslednje tri (3) godine. |
| 2.1.4. Të dëshmojë njohuri dhe shkathtësi të vlerësimit të proceseve arsimore, pedagogjike e ligjore për së paku njërin nivel të arsimit në Republikën e Kosovës; | 2.1.4. To demonstrate knowledge and skills of evaluating educational, pedagogical and legal processes for at least one education level the Republic of Kosova; | 2.1.4. Da dokaže znanje i veštine vrednovanja obrazovnih, pedagoških i pravnih procesa za najmanje jedan nivo obrazovanja u Republici Kosovo |
| 2.1.5. Të dëshmojë aftësi në fushën e teknologjisë së informacionit dhe njohje të së paku një gjuhe të huaj; | 2.1.5. To demonstrate skills in the field of information technology and knowledge of at least one foreign language. | 2.1.5. Da dokaže veštine iz oblasti informacionih tehnologija i poznavanje najmanje jednog stranog jezika. |
| 2.1.6. Plan cilësor për avancimin e punës së inspektoratit të arsimit, i cili parashikon rritjen e efektivitetit dhe të rezultateve të punës së kryeinspektorit; | 2.1.6. Qualitative plan for the advancement of the work of the education inspectorate, which foresees the increase of effectiveness and work results of the Chief Inspector; | 2.1.6. Kvalitativni plan za unapređenje rada inspektorata za obrazovanje, koji predviđa povećanje efektivnosti i rezultata rada glavnog inspektora; |
| 2.1.7. Ministria mund të shtojë kritere të tjera në konkursin për kryeinspektor; | 2.1.7. The Ministry may add other criteria to the competition for the Chief Inspector. | 2.1.7. Ministarstvo može dodati i druge kriterijume na konkurs za glavnog inspektora. |
